

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA
“TE-ZI CONSTRUCTION” SHPK

Sot ne daten 04/12/2023, ne ortaket themelues :

ENDRI ZIKAJ, i datelindjes 21.01.1989, lindur ne Tirane, Shqiperi, banues ne Tirane, i pajisur me leternjoftimin me nr.personal I90121055Q,

ET-HEM TELHA, i datelindjes 04.06.1967, lindur ne Shijak, Shqiperi, banues ne Tirane, i pajisur me leternjoftimin me nr.personal G70604003G,

Ne baze te ligjit nr . 9901 date 14.04.2008 ‘Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ‘ dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 ‘Per qendren kombetare te regjistrimit ‘ kemi vendosur te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “TE-ZI CONSTRUCTION” SHPK.

Neni 1 :

Emertimi i shoqerise

Shoqeria do te quhet “TE-ZI CONSTRUCTION” SHPK dhe eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti , ligjit nr.9901 date 14.04.2008 si edhe ligjit per QKR.

Neni 2

Selia e shoqërisë

Shoqeria do te kete seline e saj ne Sharre, Tirane – Nr pasurie 426/105-N7, Zona Kadastrale 3321. Shoqeria mund te krijojë dege , filiale , zyra përfaqësim ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj: Grumbullim, transportim dhe depozitimi i dherave dhe mbejtjeve të llojeve të ndryshme urbane. Germime dheu me punime eventuale murature e beton armeje, sistemime, taracime, prishje dhe punime në toke të germuar, prodhim dhe tregtim të materialeve të ndertimit. Ndertime dhe mirembajtje e veprave civile dhe industriale, realizimi i objekteve hidroteknike, ujesjelles



- Kanalizime, KUZ dhe KUB, gazesjelles, ndertimin e ndertesave publike dhe private, banesa dhe godina social - kulturore, mbrojtje lumore, bonifikime, stabilizimi i reshqitjeve, rehabilitim digash dhe rezervuaresh, sisteme vaditje dhe kullimi ndertim rruge, asfaltim, punime të të gjitha kategorive, punime për ndertimin dhe mirembajtjen e rrugëve automobilistike dhe infrastruktures rrugore, sinjalizimit dhe vijeimit në rruge.

Punime nentoke, ura, vepra ujore, ndertime dhe mirembajtje të llojeve të ndryshme, punime hekurudhore, tunele, linja tramvai, pista aeroportuale, etj. Ndertime dhe mirembajtje e veprave elektrike TU, TM dhe nenstacione elektrike. Studim, projektim, ndertim e zbatim të veprave ndertimore të të gjitha llojeve sipas legjislacionit shqiptar. Import – eksport i të gjitha materialeve, tregti të mallrave të ndryshme. Prodhim dhe shitje të materialeve të ndertimit dhe të parafabrikanteve të ndryshme, mirembajtje fasadash, punime restaurimi, restaurim i ndertesave, punime karpentiere, druri, metalike, punime të mirembajtjes, tregtim të të gjitha llojeve, materiale ndertimi, paisjeve hidraulike, hidrosanitare, elektrike, lende të para, inerte, produkte të gatshme e gjysem të gatshme, etj. Mirembajtje të ambjenteve të gjelbra, punime sistemim lulishte, dekorimi etj.

Ndertim dhe mirembajtje të impianteve të grumbullimit, trajtimit dhe riciklimit të mbetjeve urbane. Tregtim me shumice e pakice import - eksport të artikujve të ndryshem. Lyerje të të gjitha llojeve. Prodhim e tregtim profile alumini, duroplasti etj. Prodhim, tregtim duralumini, punime druri dhe plastike, fasada xhami etj. Dekor, ndricim dhe sinjalizim urban. si dhe cdo aktivitet tjetër të lejuar me ligj.

Neni 4

Kapitali i shoqërisë

Kapitali i shoqërisë “TE-ZI CONSTRUCTION” Shpk do te jete 100.000 Leke .

Ky kapital perbehet nga 2 kuota dhe zoterohet ne masen 50% nga ortaku ENDRI ZIKAJ dhe 50% nga ortaku ET-HEM TELHA.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar .

Neni 6

Organet e shoqerise

- 1.Asambleja e përgjithshme
- 2.Administratori

Asambleja e Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin,likuiduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire pergatitjen pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute.

ADMINISTRATORI

Administrator i shoqerise do te jete Z. ENDRI ZIKAJ , i datelindjes 21.01.1989, lindur ne Tirane, Shqiperi, banues ne Tirane, i pajisur me leternjoftimin me nr.personal I90121055Q i cili emerohet per nje periudhe 5-vjeçare, me te drejte ripertesitje te ketij afati.

Administratori mund te shkarkohet ne do moment nga asambleja, me shumice te thjeshte te votave, me kusht qe ne mbledhje te marrin pjesë ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% të kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtone apo kufizojne kete te drejte.

NENI 7

Shperndarja e fitimit vjetor të shoqerise

Pjesa e fitimit qe i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e pergjithshme.



Asambleja e Përgjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakëve pjesën e fitimit ne raport me vleren e kapitalit të regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqësojnë.

Po ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

NENI 8

Prishja e shoqerise.

Shoqeria priset :

a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,

b)me vendim te asamblese se pergjithshme,

c) me hapjen e procedurave te falimentimit,

ç)nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 3.5.2007 per "OKR",

d) me vendim te giykates,

dh) per arsye te tjera te parashikuara ne statut.

NENI 9

Likuidimi I shoqerise.

Ne rast te likuidimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emeron nje likuidator, I cili administron shoqerine deri ne mbylljen e progesit te likuidimit.

Me vendimin e posacem te Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise,likuidatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve. Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj. Shoqeria e publikon dy here kete njoftim, me nje interval prej 30 ditesh, ne faqen e saj te internetit, si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

NENI 10

Perfundimi i likuidimit

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise.

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund te kundershohet pas cregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

ENDRI ZIKAJ



ET-HEM TELHA

